



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetnistva i  
Tergovine- Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 dhe në Vendimin nr. 5235 dt. 15.07.2021, me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese /përpunuese**

MINT/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme (NMVM). Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë qytetar të Republikës së Kosovës.

Buxheti i planifikuar për subvencionim për këtë thirrje është **700,000.00 €**. Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Granti do të ndahet në tri Lot-e, si vijon:

Loti 1 – Ndërmarrjet mikro (të punësuar deri 9 punëtorë),  
Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve mikro është **300,000.00 €**

Loti2 – Ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtorë),  
Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të vogla është **250,000.00 €**

Loti3 – Ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri 249 punëtorë),  
Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të mesme është **150,000.00 €**

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT / KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në platformën e-Kosova në linkun: [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe [kiesa.rks-gov.net](http://kiesa.rks-gov.net) dhe për të aplikuar online kliko këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/DynamicForm/CompleteDynamicForm/1590>

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 08.09.2022 deri më datë 28.09.2022